

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.4

Nr. 171 prot

Tiranë më 22.02.2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele.

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional"; DROFPP Nr.4, ju njofton krijimin e vendit të lire të punës. lëvizje paralele për pozicionin:

**Specialist/e në Sektorin e Administrimit të Formimit Profesional ----1 Person**

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:**

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:**

- të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- të ketë të paktën 3 (tre) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

**2. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lire, duhet të përshihë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën dhe dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

m. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.  
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin DROFPP NR.4 Tirane, brenda datës 02.03.2023

Duke ju falenderuar për mirekuptimin

